



Permbledhje joteknike e aktiviteteve

“ID 3.7 Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur”

“ID 3.11 Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike”



Subjekti: “Sevast” sh.p.k.

Vendndodhja: Fshati Drashovicë, Kotë, Bashkia Selenice, Qarku Vlorë.

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2022



PERMBAJTJA

- + Hyrje**
- + Baza ligjore**
- + Metodika e vleresimit te mjedisit**
- + Objektivat dhe qellimi i VNM-se**

- 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
- 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
- 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVENE MJEDIS**
- 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
- 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit nezbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Operatori "Sevast" shpk eshte regjistruar me nr. NIPT J97201201R, me adrese kryesore, ku do te zhvillohet aktiviteti Fshati Drashovice, Kotë, Sarande, Vlorë.



Koordinatat ne systemin ALBANIAN 1986/GK4

X	Y
4480640	4377760
4480780	4377760
4480820	4377975
4480680	4377975

Prodhimi i inerteve realizohet nga shfrytezimi i karrieres dhe me pas materiali i perfituar transportohet per ne impiantin e thyerjes dhe te franksionimit. Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne kete zone kane si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit te zones ne forme te gureve te prodhuar direkt nga karriera dhe te materialit te perpunuar e fraksionuar si rere, granil apo çakull te madhesive te ndryshme. Per kete arsye, ne varesi te tregut te studiuar dhe te pritshem, subjekti parashikon nje prodhim 300 m³/ore.

Sistemi i shfrytezimit treguesit tekniko-ekonomike:

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:

- Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterility



- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit
- Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj

Gjate shfrytezimit te karrieres ngarkimi i materialit behet me eskavator dhe transporti per ne impiantin e perpunimit.

Per ngarkim gurit gelqeror ne shkallet e karrieres perdoren eskavatore te fuqishem me kapacitet kove 2 m³ – 3 m³, i shoqeruar me fadrome me kove me kapacitet 5 m³. Fadromat bejne zhvendosjen e gurit gelqeror ne sheshe ne nje distance maksimale 80 m si dhe per pjesen e poshtme transportin e tij drejt bunkerit te pranimit te impiantit. Bazuar ne pershkrimin gjeologjik te vendburimit dhe ne ate hidrogjeologjik mund te themi se gelqeroret kane pamje bllokore, kompakte, me çarshmeri te ulet qe i ndajne gelqeroret ne blloqe nga 50 x 100 -200 cm dhe me linja tektonike te rralla bejne ate qe kushtet e shfrytezimit te zones te jene te mira dhe per hire te lartesis, klimes dhe kushteve hidrogjeologjike te favorshme te punohet ne vendburimin gjate gjithe vitit dhe me tre turne. Bazuar ne pershkrimin gjeologjik te vendburimit dhe ne ate hidrogjeologjik mund te themi se gelqeroret kane pamje bllokore, kompakte, me thyeshmeri te ulet qe i ndajne gelqeroret ne blloqe nga 50 x 100 -200 cm dhe me linja tektonike te rralla bejne ate qe kushtet e shfrytezimit te zones te jene te mira dhe per hire te lartesis, klimes dhe kushteve hidrogjeologjike te favorshme te punohet ne vendburimin gjate gjithe vitit dhe me tre turne.

Shoqeria “Sevast” Sh.p.k ne organizimin e punes ka investuar ne kompletimin e karrieres me makineri bashkekohore duke ndihmuar ne krijimin e kushteve optimale te punes per punonjesit duke bere te mundur qe ne kete karriere shumica e punimeve te kryhen me makineri. Kjo shoqeri gjate kohes se shfrytezimit eshte marre edhe me rehabilitimin e pjeseve te shfrytezuara te karrieres ne te cilat ka mbjelle fidane te ndryshem qe rriten ne zone. Nje kujdes i vecante tregohet ne sheshin e depozitimit ku per te evituar krijimin e pluhurit gjate ngarkimit te mjeteve kryhen sperkatje me uje duke minimizuar ngritjen e grimcave te ngurta ne ajer gjate procesit te punes.

Karakteristiket e linjes:

Linja e prodhimit dhe fraksionimit te inerteve, ka nje kapacitet prodhues 300 m³/ore. Impjanti perbehet nga nje bunker qe sherben per pritjen e lendes se pare bruto me ushqyesin e tije, seleksionuesi I lendes se pare, dy sisteme sitash me vibrim (sistemi Nr.1dhe 2); nje gurcopetues tip rotori dhe nje mulli me çekiça per copetimin dhe bluarjen e gurit; trasportjeret si dhe nje gabine elektrike me trasformator mbi 500kw. Shoqeria gjithashtu disponon kamiona(3cope); fadrona (1 cope) ekskavator (1 cope), magazine, zyre si dhe ambientet higjeno-sanitare.

Pershkrimi I impjantit dhe te proceseve qe ndodhen ne te



Sheshi per depozitimin e lendes se pare, ku dhe behet depozitimi i materialeve te gurit gelqeror te siguruara nga shfrytezimi i karrieres se shoqerise “SEVAST” shpk ne nje largesi rreth 500-600 m.

Impianti ka dy linja prodhimi

1- Linje per fraksionimin e gurit geiqeror

Bunker- transportier- site me tre kate — produkt, rere, granil 10-20 mm dhe material + 30mm, i cili kalon ne linjen e dyte.

2- Linje per bluarjen e fraksionimit

Fraksioni + 30mm - bunker- ushqyes-mulli me shufra-transportier- site me tre kate- produkt I gatshem, rere e imet, granil 5 — 10mm dhe granil 10 — 20 mm, 20 — 40 mm.

Procesi Teknologjik.

Materiali i depozituar i cili manipulohet me mjetet e ngarkim — shkarkimit per ne linjen e pare depozitohet ne bunker, me pas ne transportier dhe kalon ne site me tre kate, nga ku behet seleksionimi nga lendet e huaja (si p.sh. dhera) te cilat me ane te transportjerit perkates grumbullohen ne fushe ne vendin e caktuar dhe largohen brenda javes per te trete (mbushie rruges)

Guri kalon ne bluarje dhe pastaj ne sistemin e sitave me kate dhe vibrim nga ku del fraksioni 10 den 20mm dhe material 40 mm.

Ne linjen e dyte te bluarjes behet fraksionimi me material 30mm, kalon ne bunker me pas ne ushqyes dhe ne mullirin me çekiça, ku behet bluarja, me pas ne transportier, ne site me tre kate ku del produkt i gatshem, rere e imet, granil 5-10mm, 10-20mm, dhe 20-40mm

Ushqyesi ben furnizimin me material te frantojos e cila ka nje dimension hyres 100 X 120 qe ben thyerjen e pare te materialit. Materiali i thyer me transportier transportohet per ne mulli ne te cilet behet thyerja e me tejshme deri ne realizimin e fraksioneve te kerkuara. Pas thyerjes me transportjer materiali kalon ne tre sita ku kryhet ndarja ne fraksionet e kerkuara dhe prodhimi i inerteve te fraksionuara

Procesi i transportimit dhe i bluarjes shoqerohet me spërkatje me ujë me qellim te evitimit te pluhurave ne mjedisin rrethues. Perdorimi I ujit në linjen e fraksionimit dhe sperkátja e territorit eieminon pluhurat gjate ketyre proceseve.

Nga bluarja dhe fraksionimi i ketij materiali merret produkt i gatshem si:

Rere:

Granil 5 den 10 mm



Granil 10 den 20 mm

Granil 20 den 40 mm

Keto produkte me pas perdoren dhe si lende e pare per linjat e betonit apo destinacion tjetër.

Lendet e para

Lenda e pare sigurohet nga shfrytezimi i karrieres se shoqerise sipas lejes se minerare te shfrytezimit. Per prodhimin e inerteve perdoret gur gelqeror i nxjerre nga shfrytezimi i karrieres se shoqerise “SEVAST“ sh.p.k. Kjo lende e pare eshte me perberj e granulometrike te ndryshme, zakonisht ka kete perberje:

CaO = 49.39-51.31% me nje mesatare rreth 50%

MgO = 5.5 1-6.22.00 % ,

Fe₂O₃ = 0.02-0.2 %

SiO₂ = 0.12-0.34 %

S₀₃ = 0.043. %

Hk = 10%

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Kotë është një fshat dhe një ish-bashki në qarkun e Vlorës, në jugperëndim të Shqipërisë. Me reformën e qeverisjes vendore të vitit 2015, ajo u bë nënndarje e bashkisë Selenicë. [1] Popullsia në regjistrimin e vitit 2011 ishte 3,516. [2] Njësia komunale përbëhet nga fshatrat Kotë, Gumeicë, Hysoverdhë, Lapardha, Mavrovë, Mazhar, Vajzë, Vodice, Shkallë Mavrovë dhe Drashovicë.

Pozita gjeografike

Vlora është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë. Vlora është qyteti i dytë më i madh portual pas Durrësit, me një popullsi afërsisht 200,000. Ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, në Detin Adriatik dhe është qendra e Rrethit të Vlorës dhe të Qarkun së Vlorës.

Kushtet klimatike

Klima e Rajonit është tipike mesdhetare me një dimër të lagësht e të ngrohtë dhe me një verë të nxehtë e cila arrin deri në 40 grade. Në përgjithësi në rrethin e Vlores, regjimi i presionit të ulet zgjat pak dhe periudha me kohe të mire është me të gjatë se në pjesët e tjera të vendit. Faktoret që përcaktojnë klimën e kësaj zone janë:

- Pozicioni gjeografik dhe afërsia me detin që zbut efektet ekstreme të klimës.
- Ndikimi i cikloneve dhe anticikloneve që rregullojnë klimën e krejt rajonit.



- Larmia e formave te relievit dhe drejtimi i percaktuar mire i vargmaleve dhe luginave. Temperaturat mesatare per Vloren ndryshojn nga 16,1 ne 17,7 grade. Ne Vlore mungojne temperaturat e uleta qe regjistrohen ne zonat e tjera te vendit. Temperaturat me te uleta, si ne te gjithë zonen bregdetare te Shqiperise, regjistrohen gjate Janarit-Shkurtit. Sasia mesatare e reshjeve arrin 1200mm/vit, pjesa me e madhe e te cilave ne nentor-dhjetor. Muajt me te thate jane Korriku, Gushti dhe Shtatori. Deti dhe format e relievit ndikojne shume ne shperndarjen e reshjeve ne rrethin e Vlores. Luginat e Shushices, Dukatit, Borshit e Vjoses sherbejne gjate gjithë vitit si zona te shkembimit klimaterik te zonave te bregdetit me ato ne brendesi. Kjo eshte arsyeja e shirave te bollshme prane zonave malore ne krahasim me zonat e tjera te rrethit. Ndersa ne zonen bregdetare te qytetit sasia mesatare e reshjeve eshte 1000mm/vit e ne Orikum 1314mm/vit, ne zonat malore si Llogara e Dukat, reshjet arrijne perkatesisht 2500 e 2453mm/vit. Numri mesatar i diteve me lageshti eshte 105 - 147dite ne vit. Debora eshte nje dukuri teper e rralle ne bregdet, ndersa ne zonat malore eshte nje dukuri normale qe fillon qe ne nentor. Pozicioni gjeografik i rrethit te Vlores ben qe zona te jete nen ndikimin e ererave te fuqishme, qe jane te ndryshme per nga forca dhe prania gjate vitit. Erera te zakonshme jane puhite detare, te cilat ndihen me shume gjate bregdetit. Rrethi i Vlores ne pergjithesi dallohet per ererat e forta, kjo per shkak te konfigurimit te relievit dhe gjirit te Vlores.

Gjeologjia

Rajoni i Vlores i takon zonës paleogjeografike jonike, e cila në perëndim kufizohet me zonën e Sazanit dhe në lindje me zonën e Krujës. Një njësi e veçantë, më e re se të parat, është ultësira pranadriatike që mbivendoset mbi të tria zonat e lartpërmendura. Zona jonike gjatë zhvillimit të vet paleogjeografik ka qenë një basen detar i thelle nga jorasiku në paleogjen, kurse dy zonat fqinje, Sazani dhe Kruja, kanë qenë basene detare të cekëtta, shpesh të dala dhe mbi ujë.

Në fillim të miocenit të mesëm, rreth 15 milion vjet më parë, zona jonike u përfshi nga proceset e rrudhosjes dhe të malformimit, duke u shndërruar dalëngadalë në stere. Në këtë kohë u formuan disa breza të rrudhosur mbiujorë me pamje antiklinale, si brezi antiklinal i Çikës, ai i Kurveleshit, etj.

Midis tyre mbeten breza nënujore në trajtë sinklinale, si ai i Shushicës, ku vendoset edhe Kuçi, Memaliajt etj. Në fund të miocenit, rreth 5 milion vjet më parë, ndodhi një rrudhosje tepër e fuqishme, që e shndërroi ultësirën pranëadriatike në strere me mjaft rrudha antiklinale e sinkinale.

Flora dhe fauna

Mbulesa bimore e rajonit është dëmtuar shumë nga shpyllëzimet për toka bujqësore (bukë), nga prerjet për dru zjarri, djegiet e bëra nga barinjët dhe nga kullotja pa kriter e bagëtisë (dhive). Bimësia më e përhapur janë shkurret e tipit mesdhetar (makja) të përbëra nga : sqina (xina), koçimarja, përralli, mersina, shqopa, cfaka (bezga), thrumja, sherebeli etj. Në luginat përhapje të gjerë ka dhe hilqja dhe rrapi. Në pjesët e larta rritet bredhi e pak pisha. Ka gjithashtu kullota të pasura verore.



Kafshe e egra

Nga kafshët e egra më shumë gjendet derri i egër dhe lepuri, të dëmtuar rëndë nga gjuetia. Haset edhe dhelpra, kunadhja, dreri (sorkadhja) gjendet ne pyllin e

mbrekullueshem te Zarelit si dhe ne pjesen e poshtme te fshatit si ne Shen Thanas, Perroi i Thate etj, shqarthe (macja e eger), lunderza (vidhra) ne lumin Shushice. Nga shpendët përhapje), kukumjaçka (bufi), qyqja, si dhe harabeli, gushkuqi dhe lloje të ndryshme shpendësh. Ne lumin e Shushicës gjenden me shumice trofta, ndërsa ne përrrenjtë qe derdhen ne lume ka shume krap te madhësive te vogla, si dhe ngjala. Ne terrenin me shkurre ka zvarranike te përmasave dhe llojeve te ndryshme, te pastuduara ende. Ka gjarpërinj me madhësi edhe mbi 2 merta, ndodhen gjithashtu edhe nepërka nje gjarpër i rrezikshëm sulmues, astriti dhe gjarpërinj me ngjyra e madhësi te ndryshme. Ne te gjitha pyjet me shkurre te bie ne sy një numër i madh breshkash.

Rrjeti hidrike dhe ujerat

Uji eshte nje pasuri natyrore me vlera te medha kombetare. Ai ka perdorim te madh ne bujqesi, ne industri dhe per furnizimin e qendrave te banuara. Rajoni i Vlores eshte nje rajon bregdetar i cili laget nga deti Adriatik edhe ai Jon, Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lumi i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Por rajoni eshte i pasur edhe me burime ujore , zona e Kuçit ka pasuri të shumta ujërash, si pak fshatra të Kurveleshit ku numërohen rreth 157 burime ujore. Pasuritë më të mëdha janë burimet e Lëpushës me 550 l/s, dhe buronjat e Kuçe me 300 l/s ; një nga burimet më të mëdha karstike të Shqipërisë jugore. Buronjat e Kuçe shkarkojnë ujërat nëntokësore që grumbullohen në masivin karstik të Kurveleshit të Sipërm, i cili gjendet rreth 600 m më lartë se vendi ku dalin Buronjat. Buronjat përfaqësojnë një objekt me rëndësi turistike për gjithë rajonin.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

- **Ndikimet ne popullsi**

Ushtrimi i aktivitetit do te kryhet larg zonave te banuara, rreth 1.5 km nga fshati Drashovice. Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesimit te tyre, duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve qe ndodhen ne fshatin prane.

- **Ndikimet nga zhurmat**



Zhurmat qe krijohen jane si rezultat i makinerive qe perdoren per transport, zhurma te tjera nuk ka gjate zhvillimit te aktivitetit, dhe sic e permendem me lart eshte larg zonave te banuara .

- **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Nga gjenerimi i ketij aktiviteti nuk ka shkarkime ne ujera.

- **Ndikimet ne toke**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngurta te cilat te perbejne rrezik per ndotjen e tokes, te vetmet mbetje qe gjenerohen jane ato qe vijne nga aktiviteti personal i punonjesve te cilat shkojne ne vendet e caktuara nga pushteti lokal, ndersa mbetjet qe gjenerohen nga seleksionimi i gurit jane ne sasi te pakta, keto mbetje qe jane sterilet ne trajten e dherave dhe gur tip cakelli te cilat perdoren per rehabilitimin e zones.

- **Ndikimet ne ajer**

Duke qene se kemi te bejme me nje aktivitet karriere dhe impiant fraksionimi, kemi nje gjenerim te pluhrave ne ajer por qe nuk shkaktojne ndotje te nje niveli shqetesues. Per ta evituar, here pas here subjekti ben sperkatje me uje te territorit.

- **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit, ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

- **Ndikimet ne perdorimin e tokes**

Aktiviteti ne fjale eshte i pajisur me nje leje minerare, dhe per kete arsye ne perfundim te shfytzimit te kesaj siperfaqe toke, do behet rehabilitimin e saj. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne perdorimin e tokes, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar per kete qellim.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V, madje jane vendosur koshat qe keto mbetje ti ndaje sipas karakterit te tyre.
- Automjetet e transportit qarkullojne me shpejtesi te ulet te menyre qe te mos krijohen vibrime.
- Ne pjesen e mbetur te siperfaqes se lire operatori ka mbjelle peme per te krijuar nje pamje vizuale te bukur por edhe per te ulur ndikimin ne mjedis.
- Operatori eshte i kujdeshem ne mirembajtjen e rruges hyrese te subjektit
- Masat per mbrojtjen kunder zjarrit te cilat jane shume te rendesishme dhe jane si me poshte:
 - Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.



- Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuaresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces
- Largimin e materialeve te ndezshme nga ambjentet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit.
- Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
- Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.

5. Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

Detyrimet e punëdhënësit

Per te shmangur aksidentet ne pune, punëdhënësi vetë i ka bërë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Detyrimet e punëmarrësit:

- Të njoh mirë proçesin e punës dhe makinerite apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojtë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme per ndihmën e shpejtë.
- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.